



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.159 Prot.

Tiranë, më 21.01.2025

V E N D I M

Nr. 18, datë 21.01.2025

Bazuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa me nr. 203 Regj., datë 10.10.2024, e paraqitur nga z. Xh. S, kundër Kopshtit të fshatit Muriqan, Bashkia Shkodër, në të cilën ai pretendon diskriminimin e fëmijës së tij të mitur, A. Xh. S., për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, në parashtrimet e depozituara pranë KMD-së, ndër të tjera, citon se: *Po ju drejtohem ju si institucion për arsye se djali im është diskriminuar nga ana e edukatoreve të Kopshtit Muriqan dhe nuk është marrë asnjë masë për këtë çështje. Nga ana tjetër, fëmijës tim nuk i sigurohet një edukatore ndihmëse. Më poshtë do të shpjegoj se si është diskriminuar fëmija im.*

Në datën 24.09.2024, është marrë vendimi i KEMPIT për edukatoren ndihmëse. Një ditë më pas, ky vendim u dorëzua te kopështi, edukatorja e A., edukatorja N. L., kur e mori vesh, ajo më tha: “Ke sjellë këtë letër, por po erdhi edukatorja ndihmëse. Pasi A. s’ka punë me fëmijët e tjerë, do të dalin jashtë me edukatoren” Ky rast është përsëritur 3 herë nga ana e edukatoreve. Rasti i fundit i këtij kërcënimi ishte në marketin e lagjes, dy-tre ditë para fillimit të kopështit dhe ditën e parë të shkollës, kur ika të kërkoj llogari nga edukatorja për rastin e përsëritur. Në vend që të shpjegohej, ajo nisi me ofendime personale dhe familjare, dhe situata degradoi në ofendime nga të dyja palët.

Ditën e martë: Kur shkoj ta marr djalin në kopësht, e gjej si zakonisht në cep të klasës, në tokë. Ditën e mërkurë: Shkoj dhe ankohem te Bashkia Shkodër dhe tek drejtoresha e kopshteve, znj. D.

D., pse nuk ka ardhur një edukatore ndihmëse për djalin tim. Ajo më siguron që do të shkojë të inspektojë çdo parregullësi në kopësht dhe do t'i japë zgjidhje problemit tim. E paralajmëroj që, nëse nuk merr masa, unë do të sjell mediat për zgjidhjen e problemit tim. Brenda ditës, drejtoresha vjen në kopësht dhe instrukton edukatorët si të mbrohen. Po ashtu, na thotë se do të na dërgojë dokumentet që duhen plotësuar për edukatoren ndihmëse dhe do të shohim nëse do ta përfitojmë apo jo. Kjo gjë i them është dhënë nga dikush tjetër dhe A. e meriton (nënkuptohet që gjëja do të zvarritet). Ditën e enjte, në mëngjes, edukatorja më jep një copë letër. E pyes: “Çfarë është kjo?” Ajo më thotë: “Ma ka dhënë drejtoresha”, por nuk e shoh të mundur ta lexoj.

Më pas, vjen emisioni “Stop”.

Ditën e premte, bëhet mbledhja e prindërve, të cilën ne si prindër u njoftuam në momentin e fundit. Në atë mbledhje, u denigrua fëmija im me aftësi ndryshe dhe iu cënua rëndë privatesia e tij nga një prind, ndërkohë që edukatorja ishte shumë e lumtur. Nuk u mor asnjë masë për përdhosjen e dinjitetit dhe shkeljen e privatesisë së fëmijës sime. Unë si prind jam i vetëdijshëm për kapacitetin e birit tim; ai është mrekullia ime, sido që të jetë, por askush tjetër nuk ka të drejtë të flasë për të dhe të denigrojë në ato menyra.

Saga vazhdon. Ditën e hënë, jemi sorrollat gjithë ditën për të nxjerrë një epikrizë (që e kishim), pasi nuk u dha informacioni i saktë. Po atë ditë shkojmë te Drejtoria e Kopshteve për të dorëzuar dokumentacionin, por drejtoresha na tha: “Unë ia kam nisur me shkrim edukatores.” Më pas, ligësia e tyre bën që dokumentacioni privat për fëmijën me aftësi ndryshe të bëhet publik në grupin e whats app-it të prindërve, duke tejkaluar çdo limit të njerzores dhe ligjores.

Ditën e martë, data 17.09.2024, bëhet një mbledhje me drejtoreshën. Ajo na njofton që ka marrë një masë ndëshkuese (tip vërejtje me shkrim) për shkeljet që kishin kryer edukatorët, por ajo pranon se nuk kishte dijeni as për mbledhjen, as për diskriminimin e fëmijës tim në atë mbledhje dhe as për publikimin e dokumenteve të fëmijës tim me aftësi ndryshe. Ne si prind kërkuam nga drejtoresha e kopshteve masën, deri në përjashtimin e edukatoreve për shkeljet e ditës së premte dhe të hënës. Ajo na kërkoi dy ditë kohë si drejtoreshë. Sot është dita e tretë që, në mënyrë jo zyrtare, na thotë: “Nuk është kompetencë e imja,” duke shpresuar se e drejta e tim biri për të qenë si gjithë fëmijët e tjerë me të drejta të barabarta pa e diskriminuar edhe veçuar po ju drejtohem instancave më të larta.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e Kopshtit Murriqan, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe marrja e masave për vendosjen e mësueses ndihmëse për fëmijën që të vazhdojë kopshtin sit ë gjithë fëmijët e tjerë.

Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, afhtësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 7 të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në kreun IV, të LMD, parashikohet një mbrojtje të posaçme nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve. Konkretisht, në nenin 20, pika 1, të LMD parashikohet : “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri shqyrtoi çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1384/1 prot., datë 02.10.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Kopshti Muriqan dhe Bashkia Shkodër.
- Me shkresën nr. 20558/1 prot., datë 20.10.2024², Drejtoria e Arsimit pranë Bashkisë Shkodër dërgoi një informacion në lidhje me këtë çështje.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Administruar pranë Komisionerit me nr.1384/2 prot., date 28.10.2024.

- Duke marrë shkas nga përgjigja e Bashkisë Shkodër, Komisioneri me shkresën nr. 1384/3 prot., datë 30.10.2024, iu drejtua Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër për informacion shtesë.
- Me shkresën nr. 2658 prot., datë 01.11.2024³, ZVAP Shkodër dërgoi pranë Komisionerit një informacion në lidhje me ankesën e z. Xh. S.
- Me shkresën nr. 1384/5 prot., datë 08.11.2024, Komisioneri ka përcjellë për përkundërshtime ankuesit shkresën nr. 2658 prot., datë 01.11.2024 të ZVAP Shkodër.
- Me email të datës 13.11.2024, ankuesi ka dërguar parashtrimet dhe ka vijuar me akuzat e tij ndaj Kopshtit Muriqan, duke theksuar se problemi i tij nuk është zgjidhur ende.
- Komisioneri, për të sqaruar të gjitha pretendimet e parashtruara nga ankuesi në emailin e datës 13.11.2024, me shkresën nr. 1384/6 prot., datë 18.11.2024, iu drejtua përsëri për informacion Kopshtit Muriqan dhe Bashkisë Shkodër.
- Me shkresën nr. 26736/1 prot., datë 25.11.2024⁴, Bashkia Shkodër dërgoi një informacion në vijim në lidhje me këtë çështje.
- Duke marrë parasysh problematikat e ngritura nga Bashkia Shkodër në lidhje me emërimin e mësueses ndihmëse, Komisioneri iu drejtua e shkresën nr. 1384/8 prot., datë 04.12.2024, për informacion shtesë përsëri ZVAP Shkodër, DRAP Lezhë, AKAP dhe MAS.
- Me shkresën nr. 3808/1 prot., datë 13.12.2024⁵, AKAP i ktheu përgjigje Komisionerit.
- Me shkresën nr. 7541 prot., datë 17.12.2024⁶, MAS i ktheu përgjigje Komisionerit.
- Me shkresën nr. 2094/1 prot., datë 23.12.2024⁷, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë i ktheu përgjigje Komisionerit.

Bazuar në nenin 33/8 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri, pasi vlerësoi kërkesën e ankuesit, caktoi datën 14.01.2025, ora 10:00, për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe njoftoi palët me shkresën nr. 1384/12 prot., datë 24.12.2024.

Seanca dëgjimore e datës 14.01.2025 u zhvillua pa pjesëmarrjen e ankuesit, z. Xh. S., babai i fëmijës A. S, dhe me pjesëmarrjen e palëve ZVAP Shkodër, përfaqësuar nga znj. S. D., sipas Autorizimit nr. 79 prot., datë 13.01.2025, si dhe Bashkia Shkodër, përfaqësuar nga z. A. T. dhe znj. Y. D., sipas Autorizimit nr. 415 prot., datë 10.01.2025.

Gjatë seancës dëgjimore, palët pjesëmarrëse sqaruan të gjithë procesin e emërimit të mësuesit ndihmës. Gjithashtu, u sqaruan dhe hapat e ndërmarrë nga secili institucion lidhur me rastin objekt

³ Administruar pranë Komisionerit me nr.1384/4 prot., date 06.11.2024.

⁴ Administruar pranë Komisionerit me nr.1384/7 prot., date 27.11.2024.

⁵ Administruar pranë Komisionerit me nr.1384/9 prot., date 16.12.2024.

⁵ Administruar pranë Komisionerit me nr.1384/10 prot., date 19.12.2024.

⁶ Administruar pranë Komisionerit me nr.1384/11 prot., date 24.12.2024.

ankese, duke theksuar faktin që numri i fëmijëve me nevoja për mësues ndihmës është më i madh se numri i mësuesve të vendosur në dispozicion. Bashkia Shodër ka marrë të gjitha masat për emërimet dhe plotësimin e këtyre mangësive. Referuar viteve të kaluara dhe evidentimit të një problematike të tillë nga ana e Bashkisë Shkodër, me vullnetin e mirë për t'i zgjidhur këto çështje, nga Këshilli Bashkiak Shkodër është vendosur që numri i mësuesve të këtij profili të shtohet me 10. Në rastin e fëmijës A. S., është emëruar një mësuese ndihmëse me orar të plotë, 30 orë, siç ka vendosur Komisioni, që mësuesja të jetë e angazhuar për plotësimin e të gjitha nevojave të fëmijës. *(Shoqëruar me dokumentacionin e emërimit të mësueses ndihmëse)*

Për arsye se ankuesi nuk ishte i pranishëm gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar nga Komisioneri, iu komunikua nëpërmjet telefonit hapat e ndërmarrë nga institucionet dhe, më pas, me email, datë 20.01.2025, ankuesi iu drejtua Komisionerit, si më poshtë: *“I nderuar Komisioner, Pas seancës dëgjimore të zhvilluar më 15.01.2025, u njoha me faktin se për djalin tim u vendos mësuese ndihmëse, siç ka vendosur Vendimi i KMCAP. Duke vlerësuar punën e Komisionerit, që me ndërhyrjen e tij u realizua kjo kërkesë, tërhiqem nga ankesa e bërë pranë tij, me shpresë se këto situata nuk do të përsëriten më në të ardhmen, jo vetëm për djalin tim, por për asnjë fëmijë tjetër me aftësi të kufizuara. Me mirënjohje, Xh. S.”*

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se kërkimi i palës ankuese, ose ajo që pala ankuese kërkonte të arrijë apo të sigurojë, nëpërmjet paraqitjes së ankesës objekt shqyrtimi dhe fillimit të kësaj procedure administrative, është përmbushur. Kjo është realizuar përmes plotësimit të detyrimeve ligjore të institucioneve përgjegjëse dhe sigurimit të të drejtave të fëmijës A. S., për një arsim të përshtatshëm dhe të mbështetjes së duhur. Në këtë mënyrë, kërkesa e ankuesit është trajtuar dhe zgjidhja është arritur, duke garantuar një mjedis edukativ të përshtatshëm dhe të barabartë për fëmijën.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”*

Neni 90, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative (K.P.A), ka parashikuar se: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb, pasi u zgjidh problematika e adresuar pranë Komisionerit.

Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 203 Regj., datë 10.10.2024, të paraqitur nga z. Xh. S., kundër Kopshtit të fshatit Muriqan, Bashkia Shkodër, në të cilën ai pretendon diskriminimin e fëmijës së tij të mitur, A. Xh. S, për shkak të “*aftësisë së kufizuar*”, duhet të deklarohet e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, për shkak se është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe nenet 32 e 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 203 Regj., datë 10.10.2024, të paraqitur nga z. Xh S., kundër Kopshtit të fshatit Muriqan, Bashkia Shkodër, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA